Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejmë: KSHPK) në seancën e 65-të të mbajtur më 15.04.2022 ka miratuar

Vendim

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave , nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm të Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit në lëndën me numër 08-4211/1 të datës 30.10.2021.

Lënda me numër 08 –4211/1 të datës 30.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4211 / 1 të datës 30.10.2021 është formuar me vetiniciativë .

KSHPK-ja në kolegjiumin e mbajtur më 20.09.2021 ka konstatuar që të kontrollojë botimet e Gazetës Zyrtare të RMV-së në vitin 2021 dhe të përcaktojë se cilët persona janë zgjedhur/emëruar, gjegjësisht cilëve persona iu është ndërprerë funksioni dhe të bëhet kontroll në evidencën e KSHPK për të përcaktuar se cilët persona nuk e kanë përmbushur detyrimin ligjor për të dorëzuar fletë anketuese në KSHPK pas zgjedhjes/emërimit apo përfundimit të detyrës.

KSHPK nga mbikëqyrja e evidencave të saj konstatoi se personi ---------- në afatin e paraparë me ligj pas përfundimit të funksionit si anëtarë në ---------- nuk ka dorëzuar fletë anketuese me çka ka vepruar në kundërshtim me nenin 82 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në bazë të nenit 114 paragrafi (3) të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK personit të emëruar i lëshoi dhe dorëzoi urdhër pagës për kundërvajtje.

Nga personi i emëruar në KSHPK u dorëzua dëshmi të pagimit të gjysmës së gjobës së vendosur nga urdhërpagesa për kundërvajtje.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së
Përgatiti: B. S, bashkëpunëtor i lartë
Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Nuri Bajrami